

VENDIM
Nr.279, datë 16.4.2004

PËR NGRITJEN E BORDIT TË KULLIMIT NË ZONËN E SHËRBIMIT TË KULLIMIT TË TIRANËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 35 e 41 të ligjit nr.8518, datë 30.7.1999 "Për ujitjen dhe kullimin", me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit të Tiranës, i cili financohet nga Buxheti i Shtetit.

2. Zona e shërbimit të kullimit të këtij bordi përbëhet nga:

a) zona e fushës Kamëz-Zallher (TRK-1), që kullon me rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 1475 ha;
b) zona e fushës Paskuqan-Kashar-Prezë dhe Gjokaj-Vorë-Marikaj (TRK-6,17), që kullon me rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 2900 ha;

c) zona e fushës Petrelë-Arbanë-Stërmas (TRK-20), që kullon me të rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 1050 ha;

ç) zona e fushës së Baldushkut (TRK-21), me sipërfaqe 430 ha;

d) zona e fushës së lumit Erzen (TRK-26,29,32,39), që kullon me rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 1014 ha;

dh) zona e fushës Bërzhitë-Fikas (TRK-47,48), që kullon me rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 225 ha;

e) pendët mbrojtëse nga përmytjet e lumenjve dhe të kanaleve të ujërave të larta;

ë) sistemi i mbrojtjes nga gërryerjet e lumenjve dhe të përrenjve.

3. Këshilli i përfaqësuesve të bordit të përbëhet nga:

a) 1 (një) përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit;

b) 3 (tre) përfaqësues nga federatat dhe shoqatat e përdoruesve të ujit, brenda zonës së shërbimit të kullimit;

c) 3 (tre) përfaqësues të komunave, brenda zonës së shërbimit të kullimit;

ç) 2 (dy) përfaqësues të bashkive, brenda zonës së shërbimit të kullimit;

d) 1 (një) përfaqësues i këshillit të qarkut;

dh) 1 (një) përfaqësues i biznesit, me veprimtari brenda zonës së shërbimit të kullimit.

4. Anëtarët e këshillit të përfaqësuesve të shpërblehen, çdo muaj, me 5000 (pesë mijë) lekë.

5. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti vjetor, i miratuar për Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit.

6. Ngarkohet Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano